

**V E N D I M**  
**Nr. 22/36, datë 23.10.2000**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR RADIO LOKALE FM PRIVATE “NGJALLJA”**

SUBJEKTIT: FONDACIONI “FRYMA E DASHURISË”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8655, datë 31.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit njëzëri

**V E N D O S I:**

1. T’i japë FONDACIONIT “FRYMA E DASHURISË” licensë duke e autorizuar të funksionojë si operator lokal radio FM privat në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë FM për një periudhë 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj license.
2. Licensa, bashkëlidhur, përmban kushtet e licensës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.